

Nr.Prot. 08/2996

Data: 31.03.2026



DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK DHE TURIZËM

UDHËZUESI PËR APLIKANTËT

**THIRRJE PUBLIKE PËR SUBVENCIONIMIN E  
BIZNESEVE START-UP DHE BIZNESET  
EKZISTUESE  
2026**

Autoriteti kontraktues:

Komuna Hani i Elezit

Afati për aplikim:

Nga 31.03.2026 deri më 14.04.2026 ora 16:00

# Përmbajtja

<b>1. THIRRJA PUBLIKE PËR SUBVENCIONIMIN E BIZNESEVE START-UP DHE BIZNESET EKZISTUESE 2026.....</b>	<b>3</b>
1.1. Synimi Kryesor .....	3
1.2. Synimet specifike .....	4
1.3. Përkrahja financiare publike e ofruar nga autoriteti kontraktues .....	4
1.4. Vlera monetare e granteve .....	4
1.5. Bashkëfinancimi në projekt .....	5
<b>2. RREGULLAT PËR APLIKIM .....</b>	<b>5</b>
2.1. Kriteret dhe dokumentet e nevojshme për aplikim .....	5
2.2. Dokumentet që duhet plotësuar për aplikim .....	5
2.3. Kostot e Kualifikueshme .....	6
2.4. Kostot e pa kualifikueshme .....	7
2.5. Veprimtaritë që nuk kualifikohen .....	8
<b>3. FAZAT E VLERËSIMIT .....</b>	<b>8</b>
<b>4. PROCEDURAT QË DUHEN NDJEKUR PËR APLIKIM .....</b>	<b>9</b>
4.1 Procedurat që duhen ndjekur për aplikim .....	9
4.2 Afati i fundit për aplikim .....	10
4.3 Numri i aplikimeve dhe granteve për aplikantë .....	10
4.4 Informata të mëtutjeshme për aplikim.....	10
4.5 Kohezgatja dhe Plani i veprimit.....	10
4.6 Nënshkrimi i Kontratës .....	11

## **1. THIRRJA PUBLIKE PËR SUBVENCIONIMIN E BIZNESEVE START-UP DHE BIZNESET EKZISTUESE 2026**

Komuna Hani i Elezit lanson thirrjen publike për subvencionimin e bizneseve start-up dhe bizneset ekzistuese që për synim ka promovimin dhe mbështetjen e sektorit privat për zgjerimin e kapaciteteve të bizneseve prodhuese dhe shërbyese, rritjen e konkurrueshmërisë së produkteve dhe shërbimeve, krijimin e vendeve të reja të punës, krijimi i mundësive bizneseve për qasje në financa, zëvendësimi i importeve dhe nxitja e eksportit si dhe zhvillimin e përgjithshëm ekonomik lokal. Për të arritur rezultate të qëndrueshme të zhvillimit ekonomik lokal, është e domosdoshme që të mundësohen forma të reja të prodhimit dhe të teknologjive të reja për të rritur produktivitetin, stabilitetin, dhe qëndrueshmërinë e bizneseve në sistemin e prodhimit, përpunimit dhe shërbimit.

Komuna Hani i Elezit dhe Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm, ka për objektiv të mbështes këto kategori: prodhimin, përpunimin dhe shërbimet. Nga segmenti i prodhimit veçohen (por nuk kufizohet) produktet nga plastika, druri, llamarina, lëkura, prodhimi i ushqimit, artizanalet, pije etj, Nga veprimtaria përpunuese veçohen (por nuk kufizohet): përpunimi i frutave, përpunimi i perimeve, etj. Ndërsa në kuadër të veprimtarisë së shërbimeve do të përkrahen bizneset si: IT, gastronomia, studiot e marketingut digjital dhe të fotografisë, shërbime filmike dhe të prodhimit, riparim të pajisjeve elektrike, shërbimet e arkitekturës, shërbime të parukerisë, shërbime të programimit (software), etj.

Gjithashtu, kjo thirrje publike inkurajon aplikime me projekte inovative nga gratë dhe të rinjtë sikur që ju bënë thirrje komuniteteve jo shumicë të aplikojnë në kuadër të kësaj thirrje.

Komuna Hani i Elezit përmes kësaj thirrje publike mbetet e përkushtuar të mbështesë projektet e qëndrueshme të udhëhequra nga gratë, të fuqizojë gratë dhe të rinjtë në të bërit biznes si dhe të rrisë kapacitetet e tyre profesionale, menaxheriale për një qëndrueshmëri afatgjate të biznesit.

### **1.1. Synimi Kryesor**

Kjo thirrje publike ka për synim kryesor zhvillimin e ekonomisë lokale përmes mbështetjes për bizneset ekzistuese dhe krijimin e bizneseve të reja duke ofruar mbështetje në ngritjen e kapaciteteve për bizneset ekzistuese dhe avancime të reja teknologjike në pajisje dhe makineri të nevojshme në procesin e punës. Po ashtu përmes mbështetjes publike dhe krijimit të bizneseve start up synohet zvogëlimi i papunësisë.

## 1.2. Synimet specifike

- Zvogëlimi i papunësisë përmes krijimit të vendeve të reja të punës, me theks të veçantë për gratë dhe të rinjtë;
- Përkrahja e zhvillimit të bizneseve të reja dhe atyre me potencial në rritje;
- Stimulimi i zhvillimit ekonomik lokal përmes prodhimit dhe përpunimit;

## 1.3. Përkrahja financiare publike e ofruar nga autoriteti kontraktues

Buxheti i kësaj thirrje është 25,000.00 € (njëzetë e pesë mijë euro) që do të ndahet për bizneset start-up dhe bizneset ekzistuese. Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën të mos shpërndajë të gjitha mjetet në dispozicion, apo të ndryshojë shumën në varësi buxhetore.

Komuna Hani Elezit, shumën e fondit të vendosur në dispozicion për vitin 2026, do ta ndajë në dy kategori:

- **LOT 1- Bizneset Start Up;**
- **LOT 2- Biznese ekzistuese (Ndërmarrjet mikro dhe të vogla);**

(me një qarkullim prej 1,000,00 € deri në 20,000,00 € nga viti i fundit kalendarik të dëshmuara nga ATK)

## 1.4. Vlera monetare e granteve

Çdo aplikacion i dorëzuar në këtë thirrje për mbështetje publike duhet të jetë brenda shumave vijuese minimale dhe maksimale:

### **LOT 1- Start-up**

Nga 500.00€ deri në 2,500.00 €;

### **LOT 2- Biznese ekzistuese (Ndërmarrjet mikro dhe të vogla)**

Nga 1,000.00€ deri në 2,500.00 €;

## **1.5. Bashkëfinancimi në projekt**

Përqindja e bashkëfinancimit nga aplikantët është obligative. Bashkëfinancimi i nevojshëm në kategorinë Start-up dhe bizneset ekzistuese nuk mund të jetë më pak se 10% Shuma që kërkohet nga Komuna Hani Elezit nuk mund të jetë më pak se 90% e vlerës totale të projekt propozimit.

Kontributi në natyrë nuk konsiderohet bashkëfinancim.

Para nënshkrimit të kontratës do të kërkohet të dëshmohet shuma e bashkëfinancimit përmes llogarisë bankare të aplikantit.

## **2. RREGULLAT PËR APLIKIM**

Ky udhëzues përcakton rregullat, kushtet dhe kriteret e pranueshme si dhe ato të papranueshme në procesin e thirrjes për mbështetje publike që nga faza e aplikimit, përzgjedhjes dhe implementimit. Në këtë thirrje janë tri kritere të kualifikueshme:

- Aplikantët që mund të kërkojnë mbështetje publike;
- Veprimtaritë për të cilat mund të jepet mbështetja publike;
- Lloji i kostove që mund të merret në përcaktimin e shumës së mbështetjes publike.

### **2.1.Kriteret e nevojshme për aplikim për LOT 1 - Bizneset Start-up**

1. Regjistrimi i biznesit duhet të bëhet para nënshkrimit të kontratës. Bizneset duhet të jenë të regjistruara në Zyrën për Regjistrimin e Bizneseve në Komunën e Hanit të Elezit.
2. Të jetë biznes që operon në Komunën e Hanit të Elezit, ku edhe do të bëhet investimi;
3. Të gjenerojë punësim me marrjen e grantit. Biznesi duhet të punësojë së paku një punonjës me marrjen e grantit. Punësimi i më tepër se një punonjësi për biznesin konsiderohet përparësi,
4. Përparësi kanë bizneset që udhëhiqen nga gratë, të rinjtë nën moshën 35 vjeçare, si dhe komunitetet jo shumicë;
5. Pronari/ja i/e biznesit duhet të jetë banor i Komunës Hani i Elezit.

## **2.2. Dokumentet që duhet plotësuar për aplikim LOT 1- Start-up përfshijnë:**

1. Formulari i Aplikimit për LOT 1- Bizneset Start UP; (Shtojca A1)
  2. Buxheti dhe burimet e financimit; (Shtojca B)
  3. Kopja e dokumentit identifikues personal valid i lëshuar nga Republika e Kosovës;
  4. Oferta (Profatura) për pajisjet/makineritë e planifikuara në projekt (*oferta duhet të përmbajë të dhëna të sakta të ofruesit në ofertë dhe të dhëna të sakta të marrësit të ofertës, gjithashtu oferta nuk duhet të jetë më e vjetër se data e shpalljes së kësaj thirrje për mbështetje*).
- <sup>1</sup> **Ofertat duhet të jenë vetëm në valutën EURO**

*Vërejtje: Dokumentet e listuara më lartë duhet të jenë me dukshmëri të qartë.*

*Dokumentet për aplikim mund të shkarkohen nga web faqen zyrtare të Komunës së Hanit të Elezit.*

## **2.3 Kriteret e nevojshme për aplikim per LOT 2 - bizneset ekzistuese**

1. Të jetë i regjistruar për aktivitetet e parapara me veprimin e propozuar në kohën e pranimit të grantit;
2. Të jetë biznes që operon në Komunën Hani Elezit, ku edhe do të bëhet investimi;
3. Të gjenerojë punësim me marrjen e grantit. Biznesi duhet të punësojë së paku një punonjës me marrjen e grantit. Punësimi i më tepër se një punonjësi për biznesin konsiderohet përparësi,
4. Pronari/ja i/e biznesit duhet të jetë banor i Komunës së Hanit të Elezit.

## **2.4. Dokumentet që duhet plotësuar për aplikim LOT 2 - Bizneset ekzistuese përfshijnë:**

1. Formulari i Aplikacionit për bizneset ekzistuese; (Shtojca A2)
2. Buxheti dhe burimet e financimit; (Shtojca B)
3. Kopja e dokumentit identifikues personal valid i lëshuar nga Republika e Kosovës;
4. Certifikatën e regjistrimit të biznesit me të gjitha informatat përcjellëse sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës, certifikata duhet të jetë e re, lëshuar nga ARBK sipas numrit unik identifikues; (e aplikueshme për bizneset ekzistuese)

---

<sup>1</sup> Për aplikacionet fituese, pas nënshkrimit të kontratës, oferta/profatura nuk mund të ndërrohet pa miratimin e komisionit.

5. Listën e punëtorëve për vitin e fundit fiskal (2025) të lëshuar nga ATK (mund të nxjerret online nga uebfaqja e ATK-së).
5. Vërtetim tatimor (jo më i vjetër se data e shpalljes së kësaj thirrje publike) me të cilën vërtetohet se aplikuesi nuk ka borxhe aktuale tatimore të pashlyera apo obligime)
6. Dëshmia për qarkullimin financiar për vitin paraprak (2025) nga ATK
7. Oferta (Profatura) për pajisjet/makineritë e planifikuara në projekt (*oferta duhet të përmbajë të dhëna të sakta të ofruesit në ofertë dhe të dhëna të sakta të marrësit të ofertës, gjithashtu oferta nuk duhet të jetë më e vjetër se data e shpalljes së kësaj thirrje për mbështetje*).
- <sup>1</sup> **Ofertat duhet të jenë vetëm në valutën EURO**
8. Foto të objektit ekzistues të biznesit si dhe pajisjeve ekzistuese (fotot duhet të jenë të dukshme qartë).

*Vërejtje: Dokumentet e listuara më lartë duhet të jenë me dukshmëri të qartë.*

*Dokumentet për aplikim, mund të shkarkohen nga webfaqja zyrtare e Komunës së Hanit të Elezit.*

## 2.5. Kostot e Kualifikueshme

Llojet vijuese të aktiviteteve në përputhje me synimet e thirrjes llogariten si shpenzime të kualifikueshme, dhe mund të financohen sipas kësaj Thirrjeje Publike:

Investimet në asete të prekshme që kanë të bëjnë me blerjen e pajisjeve, makinerisë, linjat e prodhimit, softuerë, si dhe të ngjashme apo/dhe përmirësimin e proceseve dhe metodave prodhuese si dhe duke përfshirë asetet që mund t'i ndihmojnë kompanive të jenë më pak të varura nga faktorët e jashtëm;

## 2.6. Kostot e pa kualifikueshme

Kostot vijuese nuk kualifikohen:

- Borxhet dhe tarifat e mbulimit të borxhit;
- Provizionet për humbje dhe detyrime potenciale të ardhshme;
- Interesat e borxhit;
- Tatimet në të hyra;

---

<sup>1</sup> Për aplikacionet fituese, pas nënshkrimit të kontratës, oferta/profatura nuk mund të ndërrohet pa miratimin e komisionit.

- Shpenzimet e deklaruara nga përfituesi dhe të mbuluara nga ndonjë veprim apo program tjetër pune;
- Blerja e tokës, ndërtimi apo riparimi i stabilimenteve/strukturave (përfshirë stabilimentet e depozitimit apo stabilimente/struktura të ngjashme);
- Humbjet në këmbim të valutës;
- Kreditë ndaj palëve të treta;
- Gjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet gjyqësore;
- Kontributet në natyrë;
- Shpenzimet e amortizimit, që normalisht duhet të jenë pjesë e mënyrës në të cilën ndahen fitimet;
- Tarifat bankare, shpenzimet e garancive dhe tarifa të ngjashme;
- Kostot e artikujve apo pajisjeve të përdorura;
- Pagat dhe mëditjet;
- Shpenzimet e lëndës së parë;
- Shpenzimet tjera operationale (qiraja, rryma, uji etj.)
- Automjetet e transportit;
- Shpenzimet e transportit;
- Inventari (Tavolinat, karriget dhe dollapet, në përjashtim ato që ndërlidhen në mënyrë specifike me veprimtarinë)

Nëse kostot e pakualifikueshme arrijnë shumën mbi 20% të vlerës së projektit aplikacioni refuzohet.

Çdo tentim për mashtrim (p.sh. falsifikimi i faturave, blerja e makinave apo pajisjeve të përdorura, etj.) do të ndëshkohet me mos-pagesë të asaj pjese që është subjekt i mashtrimit dhe ndëshkime shtesë deri në përjashtim total nga pagesa, siç parashihet me sistemin ndëshkimor që është pjesë e kontratës.

Është në interesin e aplikantit të paraqes **buxhet realist dhe efektiv për kostot.**

## 2.7. Veprimtaritë që nuk kualifikohen

**Tregtia** (me pakicë e shumicë), **ndërtimtaria**, **bujqësia** (çdo pajisje apo aktivitet që ndërlidhet me fushëveprimtarinë e bujqësisë që financohet nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Ministria Bujqësisë, përjashtimisht pajisjet/makineritë për prodhimin dhe përpunimin e produkteve) **arsimi dhe shëndetësia janë sektorë që NUK KUALIFIKOHEN.**

### **3. FAZAT E VLERËSIMIT**

#### **3.1. Kontrolli Administrativ**

Në fazën e kontrollit administrativ të aplikacioneve për grante, Komuna Hani i Elezit do të shqyrtojë dhe verifikojë aplikacionet e pranuar. Në këtë fazë verifikohet se a janë dorëzuar të gjitha dokumentet e nevojshme të kërkuara në udhëzues.

Në përgjithësi, faza e kontrollit administrativ të programit të grantit është një hap i rëndësishëm për të siguruar që fondet e grantit të shpërndahen në mënyrë të drejtë dhe efektive, dhe që projektet e zgjedhura janë në përputhje me udhëzimet në këtë dokument. **Aplikimet që nuk kalojnë kontrollen administrative, nuk kalojnë në fazën e dytë të vlerësimit.**

Vlerësimi i Aplikacioneve do të përfshijë një kontroll administrativ për të siguruar që aplikantët kanë përmbushur rregullat e kualifikimit (p.sh. aplikantët janë shtetas të Kosovës, si dhe biznesi është regjistruar në Kosovë dhe vepron në territorin e Komunës së Hanit të Elezit).

#### **3.2. Vlerësimi i projekt-propozimit – kriteret**

Projektet që kalojnë fazën e kontrollit administrativ, kalojnë në fazën e vlerësimit të projektit. Kjo fazë do të përfshijë vlerësimin e zbatueshmërisë dhe impaktit të mundshëm të projekteve të propozuara, si dhe rëndësinë e tyre për ekonominë dhe komunitetin lokal.

Procesi i vlerësimit teknik do të konsiderojë nëse aplikacioni demonstroi që ndërmarrja ka perspektivë të mirë të të qenit e suksesshme dhe e qëndrueshme, si dhe që implementimi do të kontribuojë drejt përmbushjes së synimeve të kësaj thirrje publike për të ndihmuar zhvillimin ekonomik lokal.

Vlerësimi bëhet me poentim nga Komisioni Komunal, duke u bazuar në tabelën e më poshtme, e cila rrjedh nga qëllimet e kësaj thirrjeje.

	<b>Pikët</b>
<b>Ideja e biznesit dhe inovacioni</b>	<b>Totali(30 pikë)</b>
Idetë inovative	10 pikë
Potenciali për adresimin e një nevoje ose një problemi real	10 pikë
Potenciali për eksport	10 pikë
<b>Potenciali i tregut dhe përvoja e aplikuesit</b>	<b>Totali(25 pikë)</b>
Madhësia e tregut dhe potenciali i rritjes	10 pikë
Avantazhi konkurrues dhe diferencimi	10 pikë
Përvoja dhe aftësitë përkatëse të aplikuesit	5 pikë
<b>Qëndrueshmëria financiare</b>	<b>Totali(20 pikë)</b>
Parashikime financiare realiste dhe të realizueshme	10 pikë
Potenciali për përfitim dhe qëndrueshmëri afatgjate	10 pikë
<b>Ndikimi social dhe mjedisor</b>	<b>Totali(25 pikë)</b>
Aplikuesi është i moshës 18 deri në 35 vjeç	5 pikë
Projekti ka ndikim pozitiv në ambient	5 pikë
Aplikuesi është grua	5 pikë
Aplikuesi është pjesëtar i komunitetit pakicë	5 pikë
Aplikuesi është me aftësi të kufizuara	5 pikë
	<b>TOTALI : 100 Pikë</b>

<sup>1</sup>Kalueshmëria e projektit është mbi 50 pikë.

### **3.3. Kontrolla në terren**

Gjatë fazës së kontrollit në terren, komisioni i Komunës së Hanit të Elezit do të vizitojë vendet ku biznesi i zhvillon aktivitetet dhe do të verifikojë nëse gjendja e aplikuesit në terren është në përputhje me projekt-propozimin e dorëzuar nga aplikuesi.

**Nëse nuk ka përputhshmëri në mes të projekt-propozimit dhe gjendjes në terren, projekt propozimi do të skualifikohet.**

## 4. PROCEDURAT QË DUHEN NDJEKUR PËR APLIKIM

4.1 Periudha e aplikimit do të jetë e hapur nga **31.03.2026** deri më **14.04.2026**. Aplikimi bëhet duke plotësuar shtojcat e parapara në pikën 2.2. për LOT 1-Start up dhe 2.4 për LOT 2- Bizneset ekzistuese dhe duke bashkangjitur dokumentet e kërkuara në këto pika të këtij udhëzuesi.

Aplikacionet duhet të plotësohen në formë kompjuterike duke mos ndryshuar formatin e aplikacioneve të dizajnuara nga Komuna e Hanit të Elezit për këtë thirrje. Aplikacionet e shkruara me dorë nuk do të pranohen.

Vetëm formularët e plotësuar me të gjitha informatat relevante në lidhje me veprimtarinë, do të kalojnë për vlerësim.

Në rastet kur ka mos përputhje të vlerave buxhetore në projekt, konfuzitet në përshkrim të projektit dhe gabim në përdorimin e formateve të përcaktuara në thirrjen për propozime, projekti do të skualifikohet.

Komuna Hani i Elezit nuk është përgjegjëse për koston që ndërlidhet me përgatitjen e aplikacionit dhe se këto shpenzime nuk janë të pranueshme nëse përfshihen në projekt. Aplikacionet mund të plotësohen në gjuhën shqipe.

### 4.2 Afati i fundit për aplikim

**Afati i fundit për aplikim është 14.04.2026, në ora 16:00.** Aplikacionet e kompletuara në një kopje fizike duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur në Qendrën për Shërbime me Qytetarë (QSHQ), Komuna Hani i Elezit me shënimin "THIRRJA PUBLIKE PËR SUBVENCIONIMIN E BIZNESEVE START-UP DHE BIZNESET EKZISTUESE", emri i plotë i aplikuesit si dhe LOT-in për të cilin aplikohet.

Aplikacionet e pranuar pas përfundimit të këtij afati nuk do të merren parasysh në çfarëdo rrethane.

### 4.3 Numri i aplikimeve

**Një aplikant nuk mund të dorëzojë më shumë se një aplikacion në këtë thirrje publike.**

Në rast se konstatohet se ndonjë aplikant ka dorëzuar më tepër se një aplikacion në këtë Thirrje publike, i njeiti do të diskualifikohet. Përfituesit (pronarët e bizneseve) që kanë përfituar grante nga donator vendor dhe ndërkombëtar gjatë vitit 2024 dhe 2025 nuk kanë të drejtë aplikimi për këtë thirrje.

### 4.4 Informata të mëtutjeshme për aplikim

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm do të caktojë zyrtarë përgjegjës për dhënien e informacioneve rreth kësaj thirrje. Megjithatë, pyetjet shitesë mund të dërgohen në email-in: [komunahaniielezit@gmail.com](mailto:komonahaniielezit@gmail.com) më së voni deri më **14.04.2026** deri në ora **16:00**. Me rastin e parashtrimit të pyetjeve ato duhet të jenë të qarta e të detajuara si dhe duhet specifikuar qartë pyetjen si dhe LOT-in të cilës i referohet.

DZHET nuk ka për obligim të ofrojë qartësime të mëtutjeshme ndaj pyetjeve që dorëzohen pas datës **14.04.2026**.

### 4.5 Kohëzgjatja apo plani i veprimit:

Kohëzgjatja e planifikuar e projektit nuk mund të tejkalojë **dy (2) muaj** (përveç nëse ndryshe parashihet me kushtet e kontratës).

### 4.6. Nënshkrimi i Kontratës dhe Ankesat

Komuna Hani Elezit do të themelojë komision të pavarur dhe profesional për vlerësimin e aplikacioneve. Pas shqyrtimit të aplikacioneve do të bëhet publikimi i listës preliminare. Pas publikimit të rezultateve preliminare aplikantët e pakënaqur mund të adresojnë ankesa përmes Qendrës për Shërbim me Qytetarë në Komunën Hani i Elezit brenda 5 ditë nga data e publikimit të rezultateve. Pas shqyrtimi të ankesave do të bëhet publikimi i listës finale të përfituesve dhe do të bëhet nënshkrimi i kontratave me përfitues.

Pas përzgjedhjes dhe para nënshkrimit të kontratës, janë të nevojshme këto dokumente:

- Konfirmimi nga banka për xhirollogarinë bankare.
- Dëshmia bankare për deponimin e mjeteve të bashkëfinancimit.
- Çertifikata e regjistrimit me informatat përcjellëse (për LOT 1- bizneset start up).
- Raporti Kreditor i lëshuar nga Banka Qendrore e Kosovës (për pronarin / pronaret dhe për biznesin).